



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5.4.2023

Nr: 274

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT PËR KRYETAR TË BASHKISË KORÇË, TË PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", Z. SOTIRAQ FILO, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot, më datë 5.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën me:

- KËRKUES:** Subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", me shkronja nistore "PS"
- OBJEKTI:** Regjistrimi i z. Sotiraq Filo si kandidat për kryetar të Bashkisë Korçë, propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023
- BAZA LIGJORE:** Nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, 67, 72 dhe 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimi nr. 1, datë 18.1.2023 "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore" dhe ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

VËREJ:

Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Në mbështetje të neneve 67, pika 2 dhe 72 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" ka depozituar në KQZ kërkesën për regjistrimin e z. Sotiraq Filo, si kandidat për kryetar të Bashkisë Korçë.

Data: 5.4.2023 Nr: 274
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Korçë, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", z. Sotiraq Filo, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

Në mbështetje të nenit 67, pika 2, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetar apo kandidatët për këshillin e bashkisë, pasi Bashkia Korçë administrohet nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë listuar:

- Kërkesë për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, Model KQZ-04-06,
- Deklaratë e kandidatit për hapje llogarie bankare të posaçme, Model KQZ-04-08,
- Deklaratë për pranimin e kandidimit, Model KQZ-04-09,
- Jetëshkrimi i kandidatit, Model KQZ-04-10,
- Kopjen e dokumentit të identifikimit të kandidatit për Kryetar Bashkie,
- Formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për Kryetar Bashkie,
- Procesverbal i dorëzimit të dokumentacionit të kandidimit, Model KQZ-00-31.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar bashkie. Nga verifikimi i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, kandidati për kryetar bashkie z. Sotiraq Filo, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, nuk është në kushtet e ndalimit parashikuar nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 5.4.2023, verifikoi dokumentacionin e kandidimit të z. Sotiraq Filo, të depozituar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe vlerëson se është në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 72 dhe 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore” dhe ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Regjistrimin e z. Sotiraq Filo, si kandidat për kryetar në Bashkinë Korçë, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Data: 5.4.2023 Nr: 274
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Korçë, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, z. Sotiraq Filo, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 5.4.2023 Nr: 274
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Korçë, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, z. Sotiraq Filo, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”